**VENDIM**
**Nr. 782, datë 15.12.2021**

# PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2022, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2022, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 53 154 530 (pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Arben Ahmetaj**

## ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

ANEKSI NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2022

| Nr. | Emërtimi i shpenzimeve | Viti 2022 (lek) |
|---|---|---|
| 1 | Pagat dhe shtesat e tjera | 31,660,650 |
| 2 | Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 5,511,830 |
| 3 | Shërbime e furniturë | 13,625,050 |
| 4 | Investime | 2,357,000 |
| | **TOTALI** | **53,154,530** |